

Aktivitet materiale	Mjete transporti	Toka	Ndertesa	Makineri Pune	Të tjera	TOTALI
<i>Kosto</i>						
Më 1 janar 2018	21,505,323	18,700,000	51,619,957	87,391,494	22,176,301	201,393,075
Shtesa			10,745,000	1,267,308	3,550,838	15,563,147
Pakësime	(692,333)				(46,920)	(739,253)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>20,812,990</b>	<b>18,700,000</b>	<b>62,364,957</b>	<b>88,658,802</b>	<b>25,680,219</b>	<b>216,216,969</b>
Shtesa	-		1,316,500	288,430	623,445	2,228,375
Pakësime	-					
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>20,812,990</b>	<b>18,700,000</b>	<b>63,681,457</b>	<b>88,947,232</b>	<b>26,303,664</b>	<b>192,141,679</b>
<i>Zhvlërësim i akumuluar</i>						
Më 1 janar 2018	(5,752,308)	-	(54,568)	(49,133,817)	(16,816,446)	(71,757,139)
Shpenzime për vitin	(1,326,886)	-	-	(2,541,158)	(1,076,923)	(4,944,966)
Pakësime	611,549	-	-	-	36,545	648,094
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(6,467,645)</b>	<b>-</b>	<b>(54,568)</b>	<b>(51,674,975)</b>	<b>(17,856,824)</b>	<b>(76,054,012)</b>
Shpenzime për vitin	(2,869,069)	-	-	(3,462,243)	(1,539,690)	(7,871,002)
Pakësime						
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(9,336,714)</b>	<b>-</b>	<b>(54,568)</b>	<b>(55,137,218)</b>	<b>(19,396,514)</b>	<b>(83,925,014)</b>
<i>Vlera e mbartur</i>						
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>14,345,345</b>	<b>18,700,000</b>	<b>62,310,389</b>	<b>36,983,828</b>	<b>7,823,395</b>	<b>140,162,957</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>11,476,276</b>	<b>18,700,000</b>	<b>63,626,889</b>	<b>33,810,015</b>	<b>6,907,150</b>	<b>134,520,330</b>



# OLA 1 sh.p.k

## SHËNIMET SHPIEGUESE

### 1. SHOQËRIA RAPORTUESE

OLA 1 sh.p.k ("Shoqëria") është themeluar dhe ushtron aktivitetin sipas legjislacionit shqiptar. Shoqëria është e regjistruar pranë Regjistrit Tregëtar Shqiptar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Selia qendrore e shoqërisë është Godina 3-katshe prane Xhamise, Fshati Gropaj, Vaqarr, Tirane

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është kryesisht në fushën prodhimit, tregtimit të veshjeve dhe konfeksioneve të ndryshme, prodhim tregtim artikuj promocionale, prodhim flamuj, uniforma pune etj.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është Z. Artur Kalemi dhe numri i punëmarrësve është 143.

### 2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

### 3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PARAQITJES

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në monedhën Lekë (ALL), e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, nëse nuk është shprehur ndryshe.

### 4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të kërkon që drejtimi të kryejë vlerësime dhe të përdorë gjykimin në lidhje me shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, dhe shënimet për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në datën e pasqyrave financiare dhe me shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit. Për shkak të natyrës së tyre, vlerësimet janë subjekt i pasigurive në matje dhe ndryshimet në këto vlerësime në periudhat e ardhme mund të kërkojnë një ndryshim material në pasqyrat financiare. Prandaj, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga shumat e vlerësuara kur ndodhja e ngjarjeve të ardhshme vërtetohet.

### 5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga Shoqëria në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

#### (a) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

#### (b) Monedha e huaj


##### *Transaksionet në monedhë të huaj*

Transaksionet e shprehura në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale të Shoqërisë me kurset e këmbimit të datave të transaksioneve.

Aktivitet dhe detyrimet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Diferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të Bankës së Shqipërisë (Lek kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 ishin si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
EUR	121.77	123.42
USD	108.64	107.82



### **(c) Instrumentet financiarë**

Shoqëria mban vetëm instrumente financiarë jo derivativë të përbërë nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare të ngurtësuara, mjete monetare dhe ekuivalentë dhe llogari të pagueshme e detyrime të përlogaritura. Njohja fillestare e instrumenteve financiarë jo derivativë bëhet me vlerën e drejtë plus, për instrumentet jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot neto të transaksionit të lidhura drejtpërdrejtë me to. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiarë jo derivativë maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Një instrument financiar njihet fillimisht në datën e tregtimit kur Shoqëria bëhet palë në termat e kontraktuara të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi maturohen ose kur Shoqëria i transferon aktivet financiare te një palë tjetër pa mbajtur kontroll thelbësor mbi rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen kur detyrimet kontraktuale të Shoqërisë anulohen ose maturohen. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten për shumën neto në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria aktualisht ka një të drejtë ligjore të detyrueshme për të kompensuar shumat dhe synon t'i kompensojë ato mbi baza neto ose të përfitojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

#### *(i) Mjete monetare dhe ekuivalentë*

Mjetet monetare dhe ekuivalentë përfshijnë paratë në arkë, depozitat pa afat, investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturitet fillestar tre muaj ose më pak, që janë subjekt i një rreziku jo të rëndësishëm të ndryshimit në vlerën e drejtë dhe që përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e detyrimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentët njihen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### *(ii) Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera*

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pas me koston e tyre të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

#### *(iii) Të pagueshme dhe detyrime të llogaritura*

Të pagueshmet dhe detyrimet e llogaritura njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më tej me kosto të amortizuar.

### **(d) Aktivet afatgjata materiale**

#### *(i) Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar të zhvlerësimit.

Nëse pjesë të rëndësishme të një grupi të aktivesh afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato do të trajtohen si elementë më vete (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Çdo fitim ose humbje nga shitja apo nxjerrja nga përdorimi e një aktivi afatgjatë material njihet në të ardhura ose shpenzime.

#### *(ii) Kostot e mëpasshme*

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të zërit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërinë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të vazhdueshëm të ndërtesës dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.



*(iii) Zhvlerësimi*

Toka, aktivet në proces nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Normat e përcaktuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

**Kategoritë**

Ndërtesa	5%
Mjete motorrike	20%
Pajisje kompjuterike dhe zyre	20-25%

Vlera e mbetur, nëse është e rëndësishme, rivlerësohet në mënyrë të përvitshme. Përmirësimet e qeramarrjeve kapitalizohen dhe zhvlerësohen për më të voglën ndërmjet jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qerasë.

**(e) Inventarët**

Inventarët përbëhen mallra të gatshëm për tregëtim dhe inventar tjetër që vlerësohet me vlerën më të ulët mes kostos historike dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme vlerësohet me çmimin e shitjes në veprimtarinë normale të biznesit minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

**(f) Zhvlerësimi**

*(i) Aktivet financiare*

Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për zhvlerësim. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive tregon që një ose më shumë ngjarje kanë patur efekt negativ mbi flukset e ardhshme monetare të gjeneruara nga ky aktiv.

Shoqëria konsideron evidencat e zhvlerësimit për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet individualisht të mëdha vlerësohen individualisht për zhvlerësim. Ato që nuk rezultojnë të zhvlerësuar vlerësohen më pas në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim të ndodhur, por ende jo të identifikuar në mënyrë individuale. Aktivet jo individualisht të mëdha vlerësohen për zhvlerësim në mënyrë kolektive. Vlerësimi kolektiv bëhet duke grupuar së bashku aktive me karakteristika rreziku të ngjashme.

Një humbje nga zhvlerësimi llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare, skontuar me interesin efektiv fillestar.

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe reflektohen në një llogari zbritjeje nga zhvlerësimi. Kur Shoqëria konsideron që nuk ka një perspektivë reale të rikuperimit të aktivit, shumat përkatëse fshihen. Nëse më vonë shumta e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit, humbja nga zhvlerësimi e njohur më parë rimerret në fitim ose humbje.

**(g) Të ardhurat**

Të ardhurat nga shitja e mallrave ose shërbimeve të Shoqërisë regjistrohen kur rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi produktin i transferohen blerësit, që ndodh zakonisht kur të drejtat ligjore i kalojnë palës tjetër. Kjo ndodh përgjithësisht në kohën kur produkti transportohet ose dorëzohet tek blerësi.

**(h) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përfshijnë:

- ✘ të ardhura interesi;
- ✘ shpenzime interesi dhe komisione bankare;
- ✘ humbjen ose fitimin nga kurset e këmbimit për detyrimet dhe aktivet financiare, raportuar neto.

Të ardhurat ose shpenzimet e interesit njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në bazë neto.



**(i) Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në fitim ose humbje, përveçse kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

*Tatim aktual*

Tatim aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar për vitin mbi fitimin e tatueshëm dhe çdo rregullim i tatimit për t'u paguar ose arkëtuar në lidhje me vitet e mëparshme. Vlera e tatimit të fitimit për t'u paguar ose arkëtuar është vlerësimi më i mirë i vlerës së tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasigurinë në lidhje me tatimin mbi fitimin, nëse ka. Tatimi aktual matet duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që pritet të hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

*Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Aktivitet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura, teprica kreditore tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme në masën që është e mundshme që përfitime të ardhshme tatimore do të sigurohen ndaj të cilave këto aktive do të përdoren. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportuese dhe pakësohen në momentin që nuk është më e pritshme që përfitimet e ardhshme tatimore do të realizohen; këto pakësime rimerren kur probabiliteti për përfitime të ardhshme tatimore përmirësohet. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme në momentin që këto do të rimerren, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që pritet të hyjnë në fuqi në datën e raportimit.





## 2. MJETE MONETARE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
<b>I. Para në dorë</b>	<b>1,137,097</b>	<b>918,546</b>
Në monedhë vendase	1,105,153	907,382
Në monedhë të huaj	31,944	11,164
<b>II. Para në bankë</b>	<b>970,441</b>	<b>1,718,818</b>
Në monedhë vendase	825,866	1,514,435
Në monedhë të huaj	144,575	204,383
<b>Total Mjete Monetare (I+II)</b>	<b>2,107,538</b>	<b>2,637,364</b>

## 3. KËRKESA TË ARKËTUESHME

Kërkesa të arkëtueshme nga klientët më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme nga klientë	45,573,477	43,815,582
<b>Totali</b>	<b>45,573,477</b>	<b>43,815,582</b>

## 3. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Tatimi mbi fitimin i parapaguar		559,425
TVSH e kreditueshme	1,569,270	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	195,496	27,837
<b>Totali</b>	<b>1,764,766</b>	<b>587,262</b>

## 4. INVENTARË

Inventarët më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Materiale te para	160,127,059	135,783,470
Materiale ndihmese	12,134,867	12,109,409
Produkt I gatshem	4,118,831	13,823,881
Mallra për shitje	14,994,020	8,295,490
<b>Totali</b>	<b>191,374,777</b>	<b>170,012,250</b>



## 6. KAPITALI AKSIONAR

Më 31 dhjetor 2019 aksionare jane Z. Artur Kalemi dhe Z. Sokol Kalemi . Kapitali i regjistruar i shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 44,000,000 LEK

## 7. REZERVA

Rezerva ligjore të krijuara nga Shoqëria më 31 dhjetor 2019 kanë një vlerë prej 143,666 LEK

## 9. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Të pagueshme ndaj furnitorëve	78,668,588	82,283,411
<b>Totali</b>	<b>78,668,588</b>	<b>82,283,411</b>

## 8 & 9 DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA

Detyrimet e tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Arketime ne avance	786,994	756,161
Pagat e punonjesve	7,001,409	5,507,002
Kontributet e sigurimeve	1,124,403	996,805
Tvsh e pagueshme	-	335,834
Tatimi i mbajtur në burim	40,277	40,277
Tatim mbi te ardhurat nga Punesimi	29,814	22,861
Tatimi mbi fitimin	107,516	-
<b>Totali</b>	<b>9,090,413</b>	<b>7,658,940</b>

## 10. TË ARDHURAT

Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë gjeneruar nga aktivitetet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Nga shitja e mallrave	176,204,429	139,414,095
Aktivitete të tjera	1,556,500	11,308,384
<b>Totali</b>	<b>177,760,929</b>	<b>150,722,479</b>

## 11. Kosto e mallrave të shitur

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Ndryshim i gjendjes materialeve/mallrave/produkte	(21,362,527)	(7,826,951)
Blerje materiale/mallra	112,014,506	74,352,839
Transport për mallrat	331,957	389,858
Taksa doganore	842,107	858,195
<b>Totali</b>	<b>91,826,043</b>	<b>67,773,941</b>

## 12. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE OPERATIVE

Shpenzimet operative janë si më poshtë:



	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Energji uje gaz karburant	3,705,862	4,064,385
Shpenzime për pritje	317,425	1,215,006
Taksa të ndryshme	720,856	1,303,454
Mirembajtje dhe riparime	1,559,726	1,828,281
Udhetime e dieta	16,667	66,208
Komisione dhe tarifa bankare	1,028,922	1,071,229
Posta dhe telefomi	1,228,741	1,138,067
Te tjera	3,227,240	3,045,209
Shpenzime për qira	2,974,584	2,974,584
Shpenzime per aktivet	1,253,737	10,229,365
Gjoha dhe penalitete	67,211	
Vlera asete te shitura		10,375
<b>Totali</b>	<b><u>16,100,971</u></b>	<b><u>26,946,162</u></b>

### 13. SHPENZIME PËR PUNONJËSIT

Kosto e mallrave të shitur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 detajohet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Pagat e punonjësve	45,915,545	39,774,347
Kontributet e sigurimeve	7,707,584	6,642,328
<b>Totali</b>	<b><u>53,623,129</u></b>	<b><u>46,416,675</u></b>

### 14. SHPENZIME FINANCIARE, NETO

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Fitime nga kurset e këmbimit	(1,747,361)	(3,901,124)
Humbje nga kurset e këmbimit	691,913	867,111
<b>Totali i fitimeve nga kurset e këmbimit</b>	<b><u>(1,055,448)</u></b>	<b><u>(3,034,013)</u></b>
Te ardhura nga interesat		(1,180,439)
Shpenzime per interesat	2,623,971	2,624,834
<b>Total I Shpenzimeve per Interesat</b>	<b><u>2,623,971</u></b>	<b><u>1,444,395</u></b>
<b>Te ardhura financiare neto</b>	<b><u>1,568,523</u></b>	<b><u>(1,589,618)</u></b>





## 15. TATIM FITIMI

Shpenzimi për tatim fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është përlogaritur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	7,548,831	5,188,519
Shpenzime të pazbritshme	67,211	804,494
Fitimi tatimor për vitin	7,616,042	5,993,013
Tatimi mbi fitimin 15%	(1,142,406)	(898,952)
Fitimi neto i vitit	6,406,425	4,289,567

Më poshte jepet norma efektive e tatim fitimit per vitin 2019 dhe 2018

	31 Dhjetor 2019	Norma e faktive e tatimit
Fitimi para tatimit	7,548,831	-
Tatimi mbi fitimin 15%	1,132,325	15.00%
Tatimi mbi fitimin per shpenzime te pazbritshme	10,082	0.13%
Total i tatim fitimit	1,142,406	15.13%

	31 Dhjetor 2018	Norma e faktive e tatimit
Fitimi para tatimit	5,188,519	-
Tatimi mbi fitimin 15%	778,278	15.00%
Tatimi mbi fitimin per shpenzime te pazbritshme	120,674	2.33%
Total i tatim fitimit	898,952	17.33%

## 16. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Pas datës së pasqyrave financiare nuk ka pasur ngjarje për të cilat të nevojiten rregullime në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Administrator

Artur KALEMI

